

“IKARUS”

Përtej artit si një mesazh kulturor



Kur më në fund jemi përpara një procesi të kryer artistik, pra jemi përpara një serie veprash gjithmonë përpiqemi të kuptojmë përse janë pikërisht ato në këtë moment të caktuar dhe nuk janë të tjera. Për ti dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, nuk më duket një ndërmarje edhe shumë e “lehtë”. Gjithsesi ja vlen të zhytesh në këtë tunel “ta meta ta physika”* me shpresën se do të kesh fatin të mund të hapësh ndonjë deriçkë atje thellë, kur them thellë besoj se jemi

mirëkuptuar që nuk kam parasysh orientimin fizik poshtë. Dhe ky udhëtim drejt kësaj thellësie të duket sikur ka për mision që në kilometrin X, (nuk disponojmë tjetër njësi matëse), patjetër që do të takohesh me një pjesë tjetër të qenies tënde e cila është nisur nga ana tjetër. Dhe imagjinoni se në këtë takim ju mbani me vete pikërisht pyetjen e fillimit, kjo është e qartë, ndërsa pjesa tjetër mbase mban përgjigjen ose pjesë të saj të cilën e ka gjetur pasi ka arritur të hapë para nesh ndonjë deriçkë. Dhe në pritje të këtij takimi kush mund të jetë përgjigja ose përgjigjet që ne kemi. Unë po them një ,le ta quajmë variantin a, ndërsa ju mund të vazhdoni me të tjerat. Mendoj se përzgjedhja e këtij subjekti, Ikarusit, është një përpjekje për të lehtësuar ankthin dhe dhimbjen që la pas rrëzimi i tij. Kjo dhimbje tani është pjesë e çdo aksidenti. Mendoj se ka dhe më tej, ky rrëzim erdhi si pasojë e një shtyese të brendshme mbase e “ngutur” për të fluturuar përtej të mundurës të Ikarusit dhe ne nuk bëmë shumë për ta ndaluar. Mbase e përdorëm guximin apo mëndjelehtësinë e tij për të vizatuar edhe njëherë kufijtë tonë. Ndoshta kjo vrasje ndërgjegjeje është një nga arsyet pse pikërisht autori përzgjodhi këtë subjekt. Ndoshta kjo ndjeshmeri e ardhur kështu papritur tek autori dhe pastaj tek ne si spektator, duket si një mesazh,[sms] që vjen nga një dërgues mistik, kurioz për të dëgjuar edhe njëherë se çmendojmë për këtë histori ne nga kjo anë, etj... . Ky ishte shkurt varianti im. Jam i bindur se çdokush që e ka parë ekspozitën ka menduar edhe variante të tjera duke e bërë subjektin e përzgjedhur mundësi për të medituar dhe diskutuar. Besoj se ky është një funksion thelbesor i çdo veprë arti apo ekspozite që pasuron ngrehinën tonë kulturore.

Miti si prag njohjeje, “Gnose”

Ardhja e mitit në të tashmen risjell edhe njëherë mes nesh diskutimin mbi thelbin e ”mesazhit” të tij, (nqs ka vetëm një mesazh!) Prej shekujsh ky rrefim ka ngjallur kuriozitetin e brezave. Si zakonisht për ngjarjet e medha dhe mesazhin që ato bartin, njerzit ndahen gjithmonë në dy grupe të medha. Një grup e kanë interpretuar si simboli i natyrshëm i progresit, i zhvillimit të teknologjisë, si beteja ndaj gati të pamundurës. Grupi tjetër si një sfidë e të riut ndaj rrezikut, këshillës së “babait”, si një mendjehetësi që rrjedh natyrshëm nga mosha. (me fjalën grup kam parasysh njerëz që vijnë nga epoka të ndryshme por që i bashkon “koha si e shkuar dhe e tashme” në një qëndrim). Edhe ne sot nuk po bejmë gjë tjetër vetëm se po perpiqemi të mirëkuptojmë herë pozicionin e njërit qëndrim dhe herë të tjetrit. Po në fakt le t’i afrohemi me konkretisht kësaj ngjarjeje secili personalisht, për aq sa mundemi, duke evituar shtresimet e shekujve [interpretimet e ndryshme] që duken si labirint xhamash akulli, dhe ngjarja parë përmes tyre të krijon iluzionin se herë e sheh qartë dhe herë shumë turbull, pa kuptuar kurrë asgjë.

...Dedalusi është mjeshtri dhe shpikësi, ”inxhinieri”. Ai është simbol i njeriut me ide dhe aftësi për ti realizuar ato duke i kthyer në makineri që e ndihmojnë për të zgjidhur situata. Ndërsa Ikarusi, është i biri....Sipas ngjarjeve [...] një ditë lind nevoja e Dedalusit të largohej nga Kreta në drejtim të Sicilisë për ti shpëtuar zemërimin të mbretit, Minosit. Rrethanat nuk i mundësonin largimin nga toka apo deti..., mendja e tij gjeniale prej shpikësi e gjeti zgjidhjen. Dhe ajo zgjidhje ishte ëndrra e çdo kujt, nëpërmjet FLUTURIMIT. Që të mos zgjatemi më pregatitjet, përfytyroni një baba në ato momente, përveç se të bëjë gati mire planin e tij inxhinjerik, (nuk ishte shaka të kaloje gjithë atë det duke fluturuar për herë të parë),

i duhej të përkujdesej edhe për të birin. Pas përgatitjeve të fundit dhe këshillave që i jep Ikarusit mbi përdorimin e krahëve të ngjitur me dyll , [mos fluturo shumë pranë valeve të detit dhe mos u ngjit shumë lart pranë rrezeve të forta të diellit, pra pak a shume përpiqu të qëndrosh në mes], vjen dhe moment i nisjes. Imagjinoni pas atij tensioni shfaqet mrekullia e fluturimit dhe ku, mbi detin Egje.(Asnje axhensi turistike nuk do të refuzonte ta fuste në paketën e saj sot këtë udhëtim). Por krejt papritur, Ikarusit, pasi i kaloi frika e parë dhe bezdia nga kruarja që i shkaktonin puplat e krahëve të lyer me dyll, i shkrepiti që ti jepte “gaz” në maksimum drejt lartësive të mbushura plot zjarr, (si të gjithë të rinjtë). Me gjith lutjet e të jatit, Dedalusit, ishte e pamundur ta ndalojë. Imagjinoni ndoshta ishte dialogu i parë dhe i fundit në qiell të hapur në ato lartësira, dhe mbase në një qosh të tij, qiellit, mund të ekzistojë ndonjë kopje e kësaj bisede. Prej shekujsh të gjithë krijues dhe kërkues nuk kanë bërë gjë tjetër në veprat e tyre vetëm se kanë kërkuar këtë dialog. Ne mungesë të tij e kanë zëvendësuar origjinalin me hamendjet e tyre mbi telajo apo lloje të tjera arti.

Është interesante të mendosh këtë proces magjik alkimie që ndodh në një vepër arti, ku fjalët e një dialogu “të padëgjuar”, të cilat përmbajnë edhe thelbin e kësaj ngjarjeje të përkthehen në shenja, ngjyra dhe personazhe të një të vërtete të largët e cila duket ashtu siç nuk ishte dhe

...

Vazhdon rrefimi; I riu po ngjitej me shpejtësi drejt diellit. Pak minuta më vonë ndodhi aksidenti tragjik që vazhdon të ketë jehonë edhe sot e kësaj dite në të gjitha edicionet qëndrore të lajmeve,

ku tymi i zi që del nga krahët e karbonizuar na mbyl në trishtim dhe nga thellësia na del një psherëtimë e shoqëruar me mendimin se mbase sikur të kish fluturuar pak më poshtë... Pikërisht në këtë pjesë të kësaj ngjarjeje të sjellë në kohë ka ndalur edhe autori me veprat e tij.

Vepra e artit si udhëtim nga ontologjia në semantikë

Duke kaluar nga rrëfimi mitologjik si pjesë e njohjes dhe kuptimit të “esencës, qënies”, mbi veprën e artit si pjesë e formimit dhe kuptimit të “shenjës”, do kërkojmë të kuptojmë mënyrën se si është përkthyer artistikisht ky subjekt. Në strukturimin e ekspozitës janë vendosur një seri pikturash në vaj, të cilat të para si një e tërë aktualizojnë atë “pjesë” të këtij miti, konkretisht atë të rrëzimit, të aksidentit siç e përmendëm. Në tërë procesin e qëmtimit të subjektit nënvizojmë se problem i Kohës dhe Hapsirës, (territori i ngjarjes artistike) është problem themelor. Për këtë arsye do donim t’i shkëpusnim dhe ti shikonim më vete në mënyrën se si i ndeshim keto dy elemente të rëndësishëm. Konkretisht mbi pikturë ato funksionojnë si shenja me një ngarkesë thelbësore në formësimin e aktit piktorik, ndërsa në mënyrën e ekspozimit, të instalimit të veprave në sallë, ato rikthehen në funksionin e tyre të “parë”, filozofik si kushte të ekzistencës së ngjarjes që rrjedh nëpërmjet orëve, apo ditëve si në rastin tonë. Për sa më sipër doja të nënvizoja se ngjarja, fabula zhvillohet si në territorin e çdo pikturë, hapësira e “vogël”, po ashtu në tërë ekspozitën, hapësira e “madhe” brenda unitetit të kohës si një e tërë.

Kohë-Hapsira

Vihet re se vetë organizimi hapsinor i ekspozitës është në sintoni të plotë me konceptin e një lëvizjeje rrethore. Kjo mënyrë e vëzhgimit brenda kësaj lëvizjeje rrethore të nëntë veprave të ekspozuara të krijon sensacionin e lëvizjes në një kohë të përsëritshme , të rikthyeshme. Në këtë situatë interaktive midis lëvizjes sonë dhe pikturave në mure, kur flasim për kohën kemi parasysh atë që ne quajmë “kohe subjektive”, apo kohë personale artistike. Dhe si e tille kjo “substancë” e prodhuar nuk ka asgjë të përbashkët me atë që jemi mësuar të gjejme në të përditshmen tonë, në “kohën objektive”.

Që në hapat e parë të ekspozitës jemi futur në kohën artistike dhe brenda kësaj kohe në botën artistike e cila shfaqet nëpërmjet tabllove si një botë e sapofilluar, si një botë pa temperaturë dhe diell pa zhurma dhe tinguj, si një shëmbëlltyrë e botës së parë, fillestare, (mundus archetypes) . Në heshtjen që i shoqëron, zhytesh si në një film pa zë, ku çdo telajo me vete është një sekuenca në të cilën arkivohet e tashmja, si fragment statik i shkukur nga koha. Kur hedh vështrimin majtas dhe djathtas mbi tabllotë të krijohet sensacioni sikur kthehesh në të kaluarën apo shkon përpara në të ardhmen. Ky iluzion uniteti na krijon idenë e kohës si një e tërë në dinamizmin e saj. Kur duam ti shkëpusim diçka kohës mjafton të kuptojmë se e gjejmë të shkuarën, (sado larg qofte ajo) në të tashmen ashtu si edhe të ardhmen po në të tashmen. Nga çdo qosh i kohës së pikturave frymon përpjekja e ankthshme për të kuptuar ku jemi apo kush jemi, ç’farë ka ndodhur apo do të ndodhë, ç’farë është kjo botë që na shfaqet etj.

Pikërisht këto ankthe ontologjike i japin gjithë ekspozitës një gjendje postmoderne. Ky qëndrim materializohet natyrshëm me variantet e paraqitura nga dita e Hënë deri në të Dielën. Dhe si rezultat i

pamundësisë së dhënies së një përgjigje përfundimtare, megjithë variantet e propozuara, autori duket se i rikthehet përpjekjeve për të dhënë “përgjigje të vogla” ose personale. Në të gjitha këto përpjekje ndihet tisi i trishtë ngjyror,(si shenjë) një sinjal i pamundësisë së dritës së plotë, apo sinjal i mbylljes, i rikthimit tek vetvëtja, shpresë e vetme e krijimit të botës personale të cilën çdo krijues do ta quante si e vetmja “botë e mundshme” e cila arrihet nëpërmjet artit. Apo mos është edhe kjo metafora e fluturimit dhe e rrezimit, ku fluturimi është një proces për të parë dhe kuptuar territore. Kur them territore përfshij këtu edhe ato shpirtërore. Dhe në këtë proces çdo përgjigje përpiqesh ta gjesh jashtë teje, “Atje, larg”. Vizualisht këtë proces e përkthen me përshkrimet e këtyre territoreve. Vendosja mbi telajo e personazheve dhe objekteve (nën një modelim plot dashuri), të cilat më shumë se sa për kuptimin e tyre parësor, “primar”, janë thirrur si shenja, në komunikim me njëra tjetrën. Në këtë marrëdhënie transformohen, rikthehen përsëri nga figura në fjalë,[alkimia]. Duke kombinuar fjalët, secili nga ne arrin të kombinojë fjali dhe mesazhe. Në këtë tërësi morfologjike, tentative jonë për të kombinuar dhe rikombinuar këto shenja, i rigjallëron ato duke i futur në një kontekst subjektiv, personal. Për rrjedhojë edhe mesazhet [SMS], që përftohen janë të ndryshme nga një vëzhgues tek tjetri. Kjo levizshmeri në thelbin semantik nenvizon edhe njëherë energjinë dhe përkohshmerinë e tyre. Krijohet ideja së bashkë me figurat ikin dhe vijnë edhe vetë ngjarjet dhe kuptimet e tyre. E gjitha kjo ndodh brenda të njëjtës masë lëndore, kohës, e palevizshme dhe gjithmone e hapur për ngjarje të ”reja”, të cilat vendosen mbi të vjetrat duke krijuar shtresa pas shtresash dhe kuptime mbi kuptimet.

Ndërsa procesi i “rrezimit”, kaq bukur i dramatizuar në këto piktura, është proces shumë i mediatizuar dhe mbase i keqkuptuar.”Rrezimi” duket se nuk është gjë tjetër vetëm se kthimi tek thellësia e qënies,

tek vetvetja, tek arketipi-si formë e parë e cila ngërthen në vetvete të gjitha imazhet, shëmbëllimet, idetë e njeriut. Për këtë arsye në këto rreshta nuk po zgjatemi më shumë mbi këtë kthim tek vetja, të bindur se çdokush ka shumë për të shtuar por në vetmi dhe në qetesi. Vetëm në këtë vetmi secili nga ne mund të gjejë të vërtetat dhe të bukurat e tij, të cilat mund të jenë të njëjta, të përaferta apo shumë të ndryshme nga të tjerët që na rrethojnë, por cilado qofshin ato duhet të jenë të respektueshme.

Me sa duket këtë kishte parasysh edhe Bodleri kur pothuaj një shekull e gjysëm përpara theksonte se kishte gjetur përcaktimin e bukurisë sipas tij, (do të shtoja edhe të vërtetës). Bodleri shkruante se “pothuaj gjeta përcaktimin e bukurisë sime, për mua ajo është dicka e zjarhtë dhe e trishtuar, pothuaj e mjegullt e cila lejon hamendësime”

Art.Dhe.an